

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil me Gjyqtarin Drilon HARAÇIA, me sekretaren juridike Valbone Hoxha, duke vendosur në çështjen juridike të paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve - Prishtinë, kundër të paditurës M. D. nga Gjakova rr..., për rimbursimin e dëmit, vlera e kontestit 725,00 €, jashtë shqyrtimit me dt.17.10.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M
PËR SHKAK TË PADEGJUESHMËRISË (MOSBINDJES)

MIRATOHET në tërësi kërkesë – padia e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve - Prishtinë, ashtu që të **DETYROHET** e paditura M. D. nga Gjakova, që në emër të regjistrimit të dëmit t'ia paguaj shumën prej **725,00€ (shtatëqind e njëzet e pesë euro)**, me kamatën përkatëse ligjore të cilën paguajnë Bankat komerciale në Kosovë, në mjetet e afatizuara mbi një vit e pa destinim të caktuar, e cila fillon të rrjedhë nga dt.07.08.2017 (si ditë e parashtrimit të padisë në Gjykatë) e tutje, e deri në pagimin definitiv si dhe në emër shpenzimeve procedurale shumën prej **20,00 € (njëzet euro)**, e të gjitha këto në afatin prej 15 ditëve nga dita e marrjes së Aktgjykimit, e nën kërcënim të përmarimit me dhunë.

A r s y e t i m

Pala paditëse në padi ka theksuar se me dt.20.08.2012 rreth orës 17:00 min në Malishevë ka shkaktuar aksident trafiku me automjetin A..., me targa të regjistrimit X. Deri te aksidenti ka ardhur kur automjeti "A" të cilin e drejtonte M. D. e cili nga pakujdesia i shkaktonte dëm të dëmtuarve nga familja R.. Automjeti i cili ka qenë shkaktar i aksidentit ka qenë pa mbulesë siguroese, respektivisht me afat të skaduar të policës së sigurimit. Të dëmtuarit pranë paditëses ka parashkruar kërkesë për kompensimin e dëmit dhe me dt.19.06.2014 janë kompensuar në shumën prej 725.00€.

Gjykata në kuptim të nenit 394 të Ligjit për procedurën kontestimore nr.38/2008 i publikuar në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës" me dt.20.09.2008, i ka dërguar të paditurës padinë dhe Aktvendimin për dhënien e përgjegjës në padi.

Duke e bërë shikimin në flete dërgesën për dorëzim personal konstatohet se e paditura e lartpërmendur e ka pranuar personalisht Aktvendimin C.nr.423/17 të dt.29.08.2017, padinë dhe provat me dt.06.09.2017, mirëpo edhe pse ka kaluar afati i paraparë për dhënien e përgjegjës në padi, e njëjta nuk e ka parashtruar përgjigjen në padi, andaj duke u bazuar në dispozitën ligjore të nenit 150.1 të LPK-së, të larte cituar Gjykata mori Aktgjykim për shkak të pa dëgjueshmërisë (mosbindjes) ndonëse janë plotësuar kushtet siç më poshtë vijojnë:

a) Të paditurit i është dorëzuar në mënyrë të rregullt padia, provat materiale dhe thirrja-aktvendimi për dhënien e përgjegjës në padi,

b) Themelësia e kërkesë-padisë rezulton nga faktet e treguara në padi, dhe

c) Faktet mbi të cilat mbështetet kërkesë-padia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vet paditësi.

Andaj, në kuptim të nenit 160.6 të Ligjit për procedurën kontestimore janë dhënë vetëm arsyet e sipërcituara që e justifikojnë marrjen e këtij Aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u vendos komfor nenit 452.1 të LPK, me ç ‘rast palës paditëse i janë pranuar shpenzimet në emër të taksave gjyqësore shumë prej 20,00 €.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË
C.nr.423/17, me dt.17.10.2017.

GJYKATËSI,
Drilon HARAÇIA

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar Ankesa në afatin prej 15 ditëve, nga dita e marrjes së tij, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj Gjykate.